



Univeristeti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti Juridik/Faculty of Law



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

Univeristeti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Emri i punimit	24.01.2024
Nr. i punimit	Nr. i protokolit
308	01-41

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, Fakulteti Juridik dhe Oda Regjionale e Avokatëve të Kosovës nënshkruan këtë:

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Me datën 24.01.2024 Oda Regjionale e Avokatëve të Kosovës dega në Prizren dhe Fakultetin Juridik, u pajtuan të bashkëpunojnë rreth shkëmbimit të ekspertizës, përvojës, trajnimeve, të përbashkëta me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në të mirë të dy institucioneve dhe në shërbim të studentëve dhe qytetarëve në përgjithësi.

Me anë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Oda Regjionale e Avokatëve të Kosovës dega në Prizren, zotohet se brenda një periudhe 3 vjeçare do të:

1. Mbështesë me ekspertizë profesionale Fakultetin Juridik në realizimin e Programit Master LL.M. "Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit"
2. Mundësojë realizimin e praktikës me studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren dhe Oda Regjionale e Avokatëve të Kosovës dega në Prizren;
3. Bashkëpunojë në sferën profesionale dhe hulumtimeve shkencore, publikimeve të përbashkëta si dhe përgatitjen e juristëve të rinj në ushtrimin e profesionit ligjor;
4. Kontribuojë në zhvillimin e Konferencave shkencore, trajnimeve profesionale, takimeve dhe raporteve hulumtuese, përgatitjes së propozimeve dhe realizimit të projekteve të përbashkëta;
5. Angazhojë avokatë që së bashku me profesorë të Fakultetit Juridik, të marrin pjesë në procedimin e rasteve reale nga praktika e tyre në mënyrë që studentët të ngritin njohuritë e tyre profesionale dhe të jenë pjesë aktive e procedimit të rasteve në Gjykatë;
6. Shkëmbejë ekspertë në fusha të caktuara juridiko-profesionale.

Ndërsa, Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, Fakulteti Juridik, zotohet se do të:

1. Ndhijmë dhe lehtësojmë takimet dhe aktivitetet e stafit të Oda Regionale e Avokatëve të Kosovës dega në Prizren me palët e interesit, siç janë: zyrtarët e Fakultetit, studentët dhe alumni, etj.;
2. Asistojmë në realizimin e praktikave profesionale/klinikave juridike me student dhe stafin e ORAK-së;
3. Definojmë nevojat për trajnime profesionale, hulumtime dhe publikime të përbashkëta, organizimit të Konferencave dhe realizimit të projekteve tjera të përbashkëta, me student dhe alumni të Fakultetit, të cilat pastaj përgatiten dhe realizohen nga ORAK-ja dhe Fakulteti Juridik;
4. Angazhojmë të gjitha kapacitetet infrastrukturore dhe ato të burimeve njerëzore në të gjitha aktivitetet e përbashkëta me OAK-në, me studentë dhe alumni, në harmonizimin dhe shkëmbimin e përvojave profesionale me praktikën dhe nevojat e tregut të punës.

Përmes këtij Memorandum Mirëkuptimi, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, Fakulteti Juridik dhe Oda Regionale e Avokatëve të Kosovës dega në Prizren, pranojnë njëri-tjetrin si partner zhvillimor në avancimin profesional të studentëve të Fakultetit Juridik dhe inkurajojnë të gjitha palët e interesuara që të mbështesin aktivitetet e lartshënuara.

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe vlen për periudhën e lartë cekur.



Në emër të:
Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren
Prof. asoc. dr. Mentor Alishani



Në emër të:
Oda Regionale e Avokatëve të Kosovës dega në Prizren
avokat Blerim Muzreku

Kryetar